



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME PALËT

Nr. 52 prot.

Tiranë më 23.02 2024

Lënda: Dërgohet raporti i monitorimit të buxhetit të DPS për vitin 2023

MINISTRISË SË EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
DREJTORISË SË BUXHETIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR
Tiranë

1. Hyrje, përshkrimi i institucionit

Drejtorja e Përgjithshme e Standardizimit (DPS), si Organi Kombëtar i Standardeve në Shqipëri, është përgjegjëse për organizimin dhe zhvillimin e gjithë veprimtarisë kombëtare të standardizimit, me qëllim plotësimin e nevojave të palëve të interesuara për standarde teknike për të gjitha fushat e ekonomisë.

Misioni i punës së veprimtarisë së standardizimit është të sigurojë plotësimin e nevojave të të gjitha palëve të interesuara (industria/biznesi, tregtia, autoritetet publike, ambientalistët, konsumatorët, SME-të, akademia) për standarde teknike bashkëkohore në të gjitha fushat e ekonomisë, në mbështetje të konkurrueshmësisë dhe reduktimit të Barrierave Teknike në Tregti.

Qëllimi është të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, kafshëve si dhe mjedisit.

Këto janë materializuar edhe ndërmjet qëllimit të programit 04160, i cili është: Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale

Për përmbushjen e sa më sipër, objektivat e DPS janë:

- Të përafrojë legjislacionin kombëtar me legjislacionin evropian dhe rregulloret evropiane të standardizimit (ETSI, CEN&CENELEC) dhe ndërkombëtare (ISO dhe IEC).
- Të zbatojë dhe rishikojë të gjithë paketën ligjore për proceset e integritit në fushën e standardizimit.
- Të organizojë dhe drejtojë punën për progresin në adaptimin e standardeve evropiane dhe informimin e ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë dhe palëve të interesuara për rëndësinë e standardeve
- Të mirëadministrojë Sistemin e Menaxhimit të Standardeve (SMS), shitjen e tyre dhe mirëfunksionimin e Autoritetit Kombëtar të Notifikimit dhe Pikës së Referimit në OBT dhe CEFTA. Të funksionojnë sa më mirë strukturat e DPS (Bordi Drejtues, Bordi Teknik dhe Komitete Teknike)

Produktet sipas Programit : Mbështetje për mbikqyrjen e tregut, infrastrukturë cilësie dhe pronësi industriale me kod 04160, janë Standarde evropiane dhe ndërkombetare të adaptuara, miratuara si SSH si dhe Shitja e Standardeve.

2. Informacion buxhetor

Në bazë të ligjit të Buxhetit Nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” si edhe në zbatim të Udhëzimit Nr.14, datë 30.05.2023 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” për periudhën Janar – Dhjetor 2023 janë planifikuar dhe shpenzuar fondet buxhetore si më poshtë:

Tabela 1. Akordimi i fondeve buxhetore për vitin 2023 dhe realizimi

Në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN BUXHETI	SHTESA	PAKESIME	BUXHETI RISHIKUAR	FAKT 2023
1	Paga	16,000	4,564	3,000	17,564	17,311
2	Sigurime shoqërore	3,200		308	2,812	2,745
3	Mallra e shërbime të tjera	4,200		1,000	3,200	2,568
4	Transferta Korente të Huaja	14,000		5,900	8,100	8,007
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	116	106		222	169
6	Investime	2,000			2,000	981
	Totali	39,516	4,670	10,208	33,898	31,781

Fondi i planifikuar buxhetor për vitin 2023 për DPS ishte në shumën 39,516 mijë lekë (tabela 1). Gjatë vitit kemi pasur ndryshim fondesh shtesa dhe pakësime si në rastet në vijim:

Referuar shkresës nr. 8402/1 Prot. datë 30.05.2023 “Miratim transferim fondi për fondin e vecantë në programin 04160, për vitin 2023” ka pasur shtesë fondi me 106,000 lekë dhe nga 116,000 lekë i planifikuar arriti në 222,000 lekë.

Referuar shkresës Nr. 13496/4 datë 08.08.2023 “Dërgohet shkresa Nr. 13496/2 Prot. datë 31.07.2023 “Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2023” në zbatim të VKM-së Nr. 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe të shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike” në pergjigje të kërkesës së DPS për fonde shtesë në fondin e pagave dhe sigurimeve për vitin 2023, u bënë shtesë fondesh në DPS në shumën 4,357,000 lekë për fondin e pagave dhe 111,581 lekë në fondin e sigurimeve shoqërore shëndetsore.

Referuar shkresës së MFE nr 17194/6, datë 26.10.2023, “Sistemim tabele për një transferim fondi për vitin 2023, u transferuan në DPA 1,000,000 lekë, nga llogaria ekonomike -602, duke pakësuar fondet nga 4,200,000 në 3,200,000 lekë.

Referuar shkresës së MFE nr 415/1 dt. 15.01.24 Mbi zbatimin e VKM Nr. 795, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e punonjësve të qeverisjes qendrore në procesin e shqyrtimit analitik të acquis (screening), në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian” fondi i pagave u rrit me 207,000 lekë.

Në fund të vitit buxheti u reduktua me fondet disponibël të papërdorura duke arritur në total për vitin 2023 në 33,898 lekë

- Struktura aktuale e DPS e miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 142 datë 26.09.2023 “Për një ndryshim në urdhrin nr. 182 datë 26.12.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit”, është me 15 punonjës.
- Gjatë vitit 2023 u krijuan vakanca në DPS pasi u larguan 3 punonjës, 2 (dy) prej të cilëve u larguan me kërkesën e tyre dhe 1 (një) punonjës doli në pension pleqërie. Në fund të vitit janë kryer procedurat për plotësimin vendeve vakante për 2 përgjegjës sektori.
- Periudha raportuese e vitit 2023 nuk ka pasur auditim të brendshëm apo të jashtëm.

3. Performanca me bazë gjinore, në nivel produkti

DPS nuk ka objekt veprimtarie të diferencuar për grupe me bazë gjinore dhe as nuk ben bën trajtime me bazë gjinore ndaj dhe nuk mund të bëhet analizë të treguesve gjinorë.

4. Performanca e Buxhetit

Për vitin 2023, DPS ka realizuar fondet buxhetore në vlerën **31,781,431** lekë nga **33,897,585** lekë, ose 94% e buxhetit vjetor të rishikuar (tabela nr 2)

Detajim i llogarive ekonomike sipas zërave të buxhetit:

- **Shpenzime për paga**(artikulli 600) është realizuar në masën 98% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023.
- **Shpenzime për sigurime shoqërore, shëndetsore** (artikulli 601) është realizuar në masën 97% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023.
- **Shpenzime për mallra, shërbime** (artikulli 602) është realizuar në masën 80% të fondit të rishikuar për vitin 2023.
- **Transferta korrente të huaja** (artikulli 605) është realizuar në masën 99 % të fondit të rishikuar për vitin 2023.
- **Transferrat për buxhetet familjare dhe individ** (artikulli 606) është realizuar në masën 76% të fondit të rishikuar të buxhetit për vitin 2023.
- **Fondi për investime** (artikulli 231) ku fondet akorduara të investimeve janë 2,000,000 lekë për vitin 2023, janë realizuar në masën 49%. Ky fond është përdorur për blerje pajisje kompjuterike dhe pajisje zyre (kondicionerë).

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë realizuar gjate vitit për bazën materiale të nevojshme për funksionimin e pajisjeve të zyrave (materiale kancelerie) dhe materiale pastrimi. Në zbatim të Udhëzimit nr. 36 dt. 17.12.2019 “Për përgjegjësitë e përdoruesve në SIMF” prej muajit Shtator 2022 nëpërmjet logimit në **AFMIS “Albanian Financial Management**

Information System”, Portali për dokumentacion në Thesar, janë kryer online të gjitha pagesat në buxhetin e shtetit. Gjithashtu nëpërmjet portalit selfcare ose sistemit të fiskalizimit kryhen të gjitha pagesat për shërbimet e kryera nga të tretë; ujë, postë, energji elektrike, telefon celular dhe telefonia fikse si dhe faturat e shitjes së standardeve.

Tabela 2 Realizimi i zërave të buxhetit ne%

Nr.	EMËRTIMI	BUXHETI RISHIKUAR	I FAKT	REALIZIMI NE %
1	Paga	17,564	17,311	98%
2	Sigurime shoqërore	2,812	2,745	97 %
3	Mallra e shërbime të tjera	3,200	2,568	80%
4	Transferta Korente të Huaja	8,100	8,007	99%
5	Trans per Buxh. Fam. & Individ	222	169	76%
6	Investime	2,000	981	49%
	Totali	33,898	31,781	94%

Të ardhurat nga shitja e standardeve

Për vitin 2023 janë shitur gjithsej **883** standarde, nga **600** të planifikuara me vlerën totale prej **1.478.194 lekë**.

4.1 Performanca jo-financiare

- **Adoptimi i standardeve evropiane e ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH)**

Gjatë vitit **2023** janë adoptuar si Standarde Shqiptare (SSH); **1,798** Standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, duke përfshirë amendamentet dhe dokumentet e standardizimit; nga të cilat:

- 901 në fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit - Sektori CENELEC/IEC/ETSI dhe
- 897 standarde nga të gjitha fushat e ekonomisë - Sektori CEN/ISO.

Fushat ku Komitetet Teknike kanë pasur numër më të madh adoptimesh janë si më poshtë: Sporte dhe sheshe lojërash;

- ✓ Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- ✓ Pajisje mbrojtëse personale;
- ✓ Sistemet e telekomunikacionit analoge dhe dixhitale;
- ✓ Pajisjet mjekësore jo aktive;
- ✓ Kimi;
- ✓ Dokumentacioni dhe informacioni;
- ✓ Informacioni dhe Teknologjia;
- ✓ Sistemet e Informacionit;
- ✓ Analizat e Produkteve Ushqimore;

- ✓ Materiale elektrike dhe elektronike;
- ✓ Plastika.

Janë shfuqizuar rreth **1,035** standarde sipas fushave të caktuara dhe Komiteteve Teknike përkatëse, duke ndjekur “ciklin e jetës” së standardit.

Janë adoptuar **100%** standardet e harmonizuara nën Direktivat përkatëse si dhe është realizuar përditësimi dhe rifreskimi i listave të tyre nga Sekretarët e KT-ve.

Janë adoptuar rreth **92** standarde me procedurë të përshpejtuar sipas kërkesave të klientëve, palëve të interesuara (biznese, institucione, laboratore, persona fizikë) kryesisht në fushat si më poshtë: Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës; Tekstile; Analizat e produkteve ushqimore. Materialet në kontakt me ushqimin; Bioteknologjia dhe Mikrobiologjia; Plastika; Teknologjia e komunikimit dhe informacionit; Pajisje elektrike dhe elektronike;

Janë realizuar **48** Mbledhje të Komiteteve Teknike (KT) dhe **107** Vendime Adoptimi dhe rreth **50** Vendime shfuqizimi, sipas fushave të caktuara për adoptimin e standardeve dhe dokumenteve të standardizimit evropiane dhe ndërkombëtare si Standarde Shqiptare (SSH), në të gjitha fushat e ekonomisë, duke përfshirë edhe fushën e elektroteknikës dhe telekomunikacionit.

- **Promovimi dhe publikimet**

Gjatë kësaj periudhe janë përkthyer dhe publikuar në faqen e web-it dhe në rrjetet sociale të DPS - [DPS Facebook](#); [DPS LinkedIn](#); [DPS Twitter](#):

- **24** artikuj të fushave si më poshtë:

- ✓ Siguria në punë,
- ✓ Shëndeti,
- ✓ Pajisje mbrojtëse personale,
- ✓ Mjekësia,
- ✓ Siguria sociale.

- **90** ekstrakte standardesh të fushave:

- | | |
|--------------------------------|----------------------------------|
| ✓ Pajisje elektroshtëpiake, | ✓ lëndë djegëse, |
| ✓ pajisje inxhinierike, | ✓ artikuj për fëmijë, |
| ✓ materiale ndërtimi, | ✓ pajisje për pishina, |
| ✓ produkte ushqimore, | ✓ sisteme alarmi, |
| ✓ kimia, | ✓ trafiku rrugor, |
| ✓ sporti, | ✓ turizmi, |
| ✓ mjeksia, | ✓ materiale për paketim, |
| ✓ siguria ushqimore, | ✓ lëndë drusore, |
| ✓ siguria e lodrave, | ✓ makineri përpunimi, |
| ✓ artikuj për fëmijë, | ✓ ndriçimi, |
| ✓ pajisje mbrojtëse personale, | ✓ makina dhe traktorë në bujqësi |

- Janë organizuar katër mbledhje, dy mbledhje e Bordit Teknik dhe dy mbledhje e Bordit Drejtues.
- Në kuadër të kalendarit të aktiviteteve promovuese të miratuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në kuadër të projektit GQSP janë organizuar 4 aktivitete

promovuese mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në infrastrukturën e cilësisë, në qytetin e Vlorës, Sarandës, Shkodrës, si dhe një aktivitet promovues mbi rolin e rëndësinë e standardeve në Bujqësi realizuar në Reç të Shkodrës.

Buletini i standardeve shqiptare është një botim informativ periodik i Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS). Për vitin 2023 janë publikuar 4 Buletine, përkatësisht: Buletini Nr. 93, 94, 95,96.

Propozime për përmirësimin e situatës, me qëllim arritjen dhe përmbushjen e objektivave:

- Plotësimi i vendeve vakante
- Emërimin e një punonjësi IT.

Ju falenderojmë për bashkëpunimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



RIZA HASANAJ

Konceptoi, Alma Kolonjari, P/Spektori